



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prizren / District	22. 11. 2021	1	with post year
Organ / District / City / town	By Post / Post No.	Service / Policy / Apparatus	Series / Number / Quantity
SKIPMSICK	5589/2021		118



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.856/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses ,kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.856/2021, të datës 07.10.2021 e parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë rruga "Fehmi Agani" nr.79/8, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 19.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për te vendosur për ankesat e ankuesve dhe e parashtruar me ankesën me numër A.nr.856/2021 të datës 07.10.2021 nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve.

II. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e ankuesve dhe e parashtruar me numër A.nr.856/2021 tw datës 07.10.2021 nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve .

A r s y e t i m

Ankuesit

dhe të punësuar në Policinë e Kosovës, përmes përfaqësuesit të tyre fizikisht me datën 07.09.2021,kanë parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës lidhur me kompensimin material për pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, pagën jubilarë dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje komfor Udhëzimit

Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Drejtoria e personelit të Policisë së Kosovës me datën 27.09.2021, ka njoftuar ankuesit se është refuzuar kërkesa lidhur me kompensimin e lartcekur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nga ana e Policisë së Kosovës.

Ankuesit e pakënaqur me përgjigjen e datës 27.09.2021 nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës, me datën 07.10.2021, përmes përfaqësuesit ligjor Avokatit [] kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin shujtës ditore, pagës së 13-të si dhe pagën jubilarë, nga viti 2018 deri 2020, respektivisht nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.10.2021, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Me datën 04.11.2021, Policia e Kosovës përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë gjithë dokumentacionin me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 07.10.2021, e parashtruar përmes përfaqësuesit të tyre në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 14.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 27.04.2021 për ankuesin [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 01.09.2021 për ankuesen [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesen [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesen [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesen [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesen [] se bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesen [] se bashku me

kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.08.2021 për ankuesin së bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Autorizim i datës 19.04.2021 për ankuesin së bashku me kontratën e punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës, formularët e vlerësimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe evidencën e pushimeve për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe 2021; Kërkesë e datës 07.09.2021 nga përfaqësuesi i ankuesve për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës e stafit civil e parashtruar ne Policinë e Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 27.09.2021 nga Policia e Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.10.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 04.11.2021 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar te gjitha provat e lendes, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës, *nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit dhe sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dëshmimeve te ofruara nga ankuesit dhe organi i punësimit, konstaton se ankuesit janë në marrëdhënie punë në Policinë e Kosovës, në Drejtorinë për Sigurimin e Objekteve me Rendësi të Veçantë dhe Personaliteteve, e që sipas kontratave të punës të dërguara nga organi i punësimit dhe të administruara në këtë vendim konsiston se ankuesit:

dhe janë të punësuar ne Policinë e Kosovës në pozitën e punës "Radiokomunikues" dhe të njëjtit sipas kontratave të punës kryejnë këto detyra të punës": *"Kujdeset për pranimin, regjistrimin, sisteminin dhe shpërndarjen e informatave. Mban shënime dhe kujdeset për veprimet e patrullave. Pranon të gjitha thirrjet telefonike dhe i shpërndan informatat. Angazhimi për mbajtjen e komunikimit te nevojshëm me Departamentet/Drejtoritë si dhe me stacionet tjera si brenda ashtu edhe jashtë rajonit. Kujdeset për sigurimin e te dhënave te kërkuara për njësitë patrulluese ne teren. Bene verifikimin e personave te dyshuar ne listat përkatëse. Bene verifikimin e veturave(për regjistrim, vjedhje, aksidente etj).Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi".*

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike, si dhe "Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune*

të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankueseve, Kolegji ka konstatuar se pozita e lartcekura hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht Kolegji konstaton se ankuesit e lartcekur nuk e kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marrë parasysh se ankuesit tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përkasin kategorisë së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit administrativo-teknik dhe mbështetës.

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *“Përveç se parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës”,* andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.856/2021 të datës 07.10.2021 të parashtruar nga ankuesit:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, atëherë udhëzon palët për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, *ka konstatuar se ankesa e ankueseve*

është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueseve lidhur me kompensimin e shujtës ditore, shpërblimin e pagës sw 13-tw, si dhe pagën jubilarë nga hyrja në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018

mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (në mënyrë retroaktive nga viti 2018 deri 2020).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve ka konstatuar se duke u bazuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesve në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafit 5 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesit janë nëpunës civil të punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton kjo dispozitë: *"5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi"*, që në kohën kur është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore që zbatohen për këtë fushë, respektivisht neni 4 paragrafi 1, të këtij ligji, i cili ka përjashtuar vetëm zyrtarët policor nga shërbimi civil në Policinë së Kosovës, mbi këtë bazë përveç tjerash të gjitha pagat e nëpunësve civil dhe shtesat e nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, rregullohen në bazë të nenit 4 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, të cilat ende kanë fuqi ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 44 paragrafin 2 si dhe duke u ndërlidhur me nenin 55 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, me të cilën baze juridike Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka kompetencë nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës për personelin policor dhe mbi të cilën bazë juridike ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018 por se që ky udhëzim do të duhej te jetë në harmoni me bazën ligjore që veç është e rregulluar një materie konkrete, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ekziston baza ligjore që e rregullon çështjen e pagave dhe shtesave të ndryshme të nëpunësve civil, siç është Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2021 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, rrjedhimisht dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk mund të parashohin të drejta dhe beneficione ndryshe nga si është rregulluar kjo çështje me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2021 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, prandaj pretendimet e ankuesëve janë të pabazuar.

Lidhur më këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesës, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datën 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe i cili është dekretuar nga Presidenti më datë 14.06.2010, e i cili është në fuqi edhe aktualisht, i cili në dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij ligji, është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me udërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, si dhe neni 4 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera, mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 14, 15, 16, 17 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenit 4 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, sepse në dispozitat të këtij udhëzimi janë përfshirë edhe shtesa dhe beneficione tjera, dhe të cilat në raport me dispozitat e ligjit për paga Nr.03/L-147 dhe Rregullores Nr.33/2012 që specifikisht rregullojnë këtë fushë nuk mund të kenë fuqi mbizotëruese për nëpunësit civil gjegjësit stafin civil në Policinë e Kosovës, andaj si i tillë Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës nuk është i zbatueshëm për këtë kategori të nëpunësve civil brenda institucionit të Policisë së Kosovës.

Lidhur me zbatueshmërinë e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me datën 04.11.2021, Policia e Kosovës, ka dhënë përgjigje në ankesën e ankuesve me numër protokoll 4955/21 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në të cilën është deklaruar se për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje për buxhet shtesë tek Ministria përgjegjëse me datën 24.10.2017, duke parashtruar kërkesë tek Ministria e Financave, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve sipas Qarkores me numër ref.2018/02 për periudhën 2018/2020, dhe e cila kërkesë nuk është aprovuar nga Ministria e Financave.

Në rastin konkret sipas këtij deklarimi zyrtarë të Policisë së Kosovës, ka vërtetuar faktin se para se ta miratojë Udhëzimin Administrativ të datës 14.11.2018, Policia e Kosovës ka qenë dashtë të këtë një miratim nga Ministria e Financave konformë nenit 47 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës e që në këtë mënyrë përmbajtjen dhe formën e kësaj rregullore e bënë pa bazë ligjore sa i përket kësaj kategorie të nëpunësve civilë.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se, Policia e Kosovës edhe për kundër faktit të mos aprovimit të kërkesës së datës 24.10.2017 nga Ministria e Financave, konkretisht Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 23 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: "1. *Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës.* 2. *Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shuma e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës",* dhe nenin 23 "Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën buxhetore të nevojshme për kompensimin dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës", mbi këtë bazë nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka apo ekziston miratimi i Ministrisë

përgjegjëse për nxjerrjen dhe zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket planifikimit buxhetor, andaj edhe pretendimet e ankueses mbi bazë të dispozitave ligjore të specifikuara më lartë janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin e ankuesve për mos kompensimin e shujtës ditore, pagën e 13-të, pagën jubilarë për vitet 2018, 2019, 2020 si dhe për vitin aktual, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe nenit 20 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nga se me asnjë dispozitë ligjore që rregullojnë shërbimin civil nuk parashihen këto beneficione, po ashtu këto kërkesa janë të vjetruara edhe sikur kjo rregullore të prodhoj efekte juridike ndaj kësaj kategorie të nëpunësve civil nga se si kërkesa janë jashtë afateve ligjore të përcaktuara në dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashitohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* e që në rastin konkretë kemi të bëjmë me pretendime ankimore që rrjedhin nga një Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ndërsa kërkesa në organin e punësimit është bërë më datë 07.09.2021, që është jashtë çdo afati ligjor sa i përket kësaj natyre të çështjes.

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi gjegjësisht të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë edhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj, ndërlidhur edhe me dispozitat transitorë të nenit 83 të këtij ligji, ku përcakton se: *"1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitë të nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesve

lidhur me kompensimin e pagës jubilarë nga ana e organit të punësimit, pas analizimit dhe dëshmimeve të ofruara nga ana e organit të punësimit-Policia e Kosovës konkretisht kërkesës për përgjigje të datës 27.09.2021 drejtuar ankuesve si dhe dëshmisë Listës së pagave nga ana e Policisë së Kosovës ka konstatuar se ankuesit kompensimi për pagën jubilarë i është ekzekutuar në muajin maj të vitit 2014, dhe kompensimi për pagën jubilarë i është ekzekutuar në muajin maj të vitit 2015, ankueses kompensimi për pagën jubilarë i është ekzekutuar në muajin prill të vitit 2016, ndërsa ankuesja sipas dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit -Policia e Kosovës, e njëjta nuk e ka arritur kohën prej dhjetë (10) vite përvojë të punës andaj edhe nuk i ka takuar kompensimi i një page jubilarë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.856/2021

Ardifa Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.